

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ACCENT SPORT EVENTS & SOLUTIONS” SH.P.K

Në Tiranë më datë 28.10.2025, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, themelohet Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar **“Accent Sport Events & Solutions” sh.p.k** me ortakë bashkëthemelues:

1. **Znj. Rezarta Mersini**, e bija e Fatmirit, datëlindja 02.08.1983, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë Kompleksi Delijorgji, me numër personal identifikimi I35802088C, shtetësia Shqiptare
2. **Z. Lysien Nurishmi**, i biri i Astritit, datëlindja 02.09.1980, lindur në Tiranë, banues në Tiranë Kompleksi Delijorgji, me numër personal identifikimi I00902100R, shtetësia Shqiptare

SELIA

Selia e shoqërisë **“Accent Sport Events & Solutions” sh.p.k** është vendosur në: Rruga Artan Lenja, Godina nr.33, 80 metra larg Kompleksit Kontakt, Tiranë. Shoqëria mund të hapë filiale brenda dhe jashtë vendit.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare është pa afat duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka për objekt të ushtrojë aktivitetet me objekt si më poshtë:

Menaxhimi dhe Organizimi i Aktiviteteve Sportive, Turneve Ndërkombëtare Sportive brenda dhe jashtë vendit; Konsulencë, Asistencë Tekniko-Ligjore dhe Trajtime për Krijimin, Organizimin dhe Menaxhimin e Klubeve të Futbollit; Asistencë Teknike dhe Trajtime Klubeve të Futbollit për Transferimin e Lojtarëve në FIFA TMS; Asistencë Teknike për Infrastrukturën e Stadioneve; Suport dhe Trajtime të Sistemit VAR sipas standarteve të FIFA-s; Dizenjimi dhe Instalimi i Mini-



fushave sportive multifunkionale, të Hapësirave Interaktive Sportive, të Sport Fun Zone në ambiente të brendshme dhe të jashtme në institucione arsimore, sportive, biznese, hapësira publike dhe rezidenca private, brenda dhe jashtë vendit; Import dhe Eksport i materialeve dhe pajisjeve IT në funksion të aktiviteteve dhe shërbimeve të sipërpërmendura; Marrëveshje bashkëpunimi me persona fizikë ose juridikë vendas e të huaj, për qëllime tregtare, teknologjike dhe logjistike. Shoqëria mund të ushtrojë çdo aktivitet ekonomik e juridik dhe të marrë pjesë në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të cilat kanë rëndësi të drejtpërdrejtë ose tërthorazi për arritjen e objektivave të shoqërisë e që mund të jenë objekt i ndryshimeve për t'iu përshtatur zhvillimeve teknike, ligjore, sportive dhe arsimore. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **10.000 lekë**, i ndarë në **2 kuota**, të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është kontribuar si vijon:

- **Znj.Rezarta Mersini** zotëron 60% të kapitalit
- **Z. Lysien Nurishmi** zotëron 40% të kapitalit.

ORGANET DREJTUESE

Organet Drejtuese të Shoqërisë “**Accent Sport Events & Solutions**” sh.p.k janë **Asambleja e Ortakëve dhe Administratori**.

ADMINISTRATORI

Shoqëria “**Accent Sport Events & Solutions**” sh.p.k do të administrohet nga **Znj. Rezarta Mersini**, me numër personal identifikimi I35802088C, banuese në Tiranë Kompleksi Delijorgji, për një afat të pacaktuar.

Administratori do të ketë të drejtë përfaqësimi të plotë të shoqërisë përpara të tretëve dhe autoriteteve publike dhe private.

NDARJA E FITIMEVE



Fitimet neto të shoqërisë që rezultojnë nga bilanci, me Vendim të Asamblesë së Ortakëve ndahen në përpjestim sipas kontributit përkatës të Ortakëve, pasi të zbriten shumat që u përkasin detyrimeve ligjore, fondit rezervë dhe të tjera të përcaktuara me ligj ose statut.

MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Ortakëve gjatë zbatimit të Aktit të Themelimit, ose midis Shoqërisë dhe Ortakëve gjatë aktivitetit të shoqërisë, duhet të zgjidhen me mirëkuptim ose nëpërmjet ndërmjetësimit. Në të kundërt Palët i drejtohen Gjykatës kompetente.

TË TJERA

Dispozita më të hollësishme për mënyrën e funksionimit të shoqërisë, përshkruhen në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi hartuar në pesë kopje të barazvlefshme, pasi u lexua u nënshkrua nga palët më poshtë:

Ortakët e Shoqërisë

“Accent Sport Events & Solutions” sh.p.k

Znj. Rezarta Mersini



Z. Lysien Nurishmi

